



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 319/3 Prot.

Tiranë, më 09.06.2017

V E N D I M

Nr.128, datë 09.06.2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 23, datë 23.03.2015 "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar", Vendimit nr. 83, datë 31.07.2015 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, dt.12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil" dhe Vendimit nr.90, datë 10.09.2015 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, datë 12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 23, datë 23.03.2015 "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar", Vendimit nr. 83, datë 31.07.2015 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, dt.12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil" dhe Vendimit nr.90, datë 10.09.2015 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, datë 12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil",

VËREJ SE:

Me Vendimin nr.01, datë 09.01.2015, "Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është realizuar inspektimi në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, pranë këtij institucioni.

Në Vendimin nr.23, datë 10.03.2015, "Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil, në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar", Komisioneri ka vendosur:

1. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar deklaramin e statusit si “nëpunës civil në periudhë prove” në pozicionin e “Përgjegjësit të Sektorit të Arkivit Qendror” dhe t’i njihet statusi i nëpunësit civil për atë pozicion që mbante në datën 26.02.2014, “Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare”.

Pozicioni i punës “Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror” të SHGJSH duhet të shpallet i lirë dhe punonjësi ***** duhet të sistemohet në një pozicion tjetër të përshatshëm me nivelin e statusit të specialistit ose të marrë pjesë në plotësimin e pozicionit të “Përgjegjësit të Sektorit të Arkivit Qendror”, nëpërmjet procedurës së konkurimit për ngritjen në detyrë.

2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të ndryshojë/korrigjojë aktin e deklaramit të statusit të punësimi për punonjësin *****, duke shënuar në këtë akt pozicionin që punonjësi mban aktualisht: “Specialist në Sektorin e Monitorimit të Lejeve të Kërkim - Zbulimit”, në Drejtorinë e Burimeve Minerale.

3. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësen e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar deklaramin e statusit si “nëpunës civil” për këtë punonjëse.

Pozicionin “Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar” ta shpallë vend të lirë pune, për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit.

4. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil në periudhë prove për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit” dhe të bëjë deklaramin e statusit në pozicionin “Specialist në Sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike”, ku ka qenë i punësuar në ditën e fillimit të efekteve të ligjit.

Pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të të Dhënave në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit”, të shpallet vend i lirë për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit.

]

5. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar deklaramin e statusit si “nëpunës civil” në pozicionin “Specialist në Sektorin e Hartografimit në Drejtorinë e Gjeologjisë”.

Ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit.

6. *Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil të nivelit të ulët drejtues për punonjësin ***** si “Përgjegjës në sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë” dhe të deklarojë statusin e tij për pozicionin që ka mbajtur në momentin e fillimit të efekteve të ligjit si “Specialist në Sektorin e Gjeodezisë, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike , Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”.*
7. *Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të revokojë shkresën Nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” për kalimin e punonjësit ***** në pozicionin Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare, si të pambështetur në ligj, për shkak se ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ai mbante pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Rrjetit Lumor”. Të shikohet mundësia për sistemimin e tij në një pozicion që përshtatet me nivelin e tij të nëpunësisë. Vendi i punës “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare” duhet të deklarohej pozicion i lirë dhe të shpallet procedura e konkurimit për plotësimin e tij sipas ligjit.*
8. *Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësen e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e Gjeofizikës”.*

Pozicioni i punës, “Specialiste në Sektorin e Gjeofizikës”, duhet të shpallet pozicion i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimit të neneve 22 e 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM-së nr.143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

9. *Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil në pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”.*

Ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të

përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

10. *Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të bëjë rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të nëpunësit civil për punonjësin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ***** dhe të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për të revokuar aktin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil në pozicionin e punës “Specialist në Sektorin e Analizave të Ujërave”.*

Ky pozicion duhet të shpallet i lirë dhe të plotësohet nëpërmjet procedurës së konkurimit, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

11. *Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të ndryshojë/korrigjojë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për punonjësin *****, duke shënuar në këtë akt pozicionin që punonjësi mban aktualisht “Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë.*

12. *Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të revokojë shkresën nr. 1353/3 Prot., datë 30.06.2014, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar” për kalimin e punonjësit ***** në një pozicion të një niveli më të lartë nëpunësie, për shkak të mosrespektimit të kërkesave të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM-së nr. 143, datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.*

Për këtë arsye, të shikohet mundësia e sistemimit të tij në një pozicion që përkon me nivelin e tij të punësimit si specialist. Pozicioni i punës “Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Rrjetit Lumor, në Drejtorinë e Hidrogjeologjisë” duhet të deklarohet pozicioni i lirë dhe të shpallet procedura e konkurimit për plotësimin e tij sipas procedurave ligjore, nëpërmjet konkurimit, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë, etj.

13. *Komisioni i Ristrukturimit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të bëjë edhe një herë rivlerësimin nga e para, të të gjithë praktikave të procesit të deklaramit apo mosdeklaramit të statusit të punësimit, për të gjithë punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, duke patur parasysh kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të VKM-së nr. 116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.*

14. *Të kërkoj nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar që të përgatiten përshkrimet e reja të punës, duke përcaktuar në mënyrë të qartë kërkesat e përgjithshme e të veçanta për secilin vend pune, sipas standardit dhe kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar , VKM-së nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin*

dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe Udhëzimit nr. 1, datë 07.04.2014, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”, dalë në bazë e për zbatimin të tij. Pasi të jetë përfunduar ky proces duhet të bëhet vlerësimi rast pas rasti nëse punonjësi që punon në një vend të caktuar pune i plotëson ose jo kërkesat konkrete të vendit të punës. Në rast se konstatohet se një nëpunës nuk plotëson kërkesat e përgjithshme apo ato të posaçme për atë pozicion ku është punësuar të veprohet sipas urdhërimit të pikës 6, të Kreut III, të VKM-së nr. 116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar”. Pasi të përfundojnë përshkrimet e reja të vendeve të punës, në zbatim të pikës 20, të Kreut IV, të VKM-së nr.116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të depozitohen pranë Departamentit të Administratës Publike. Nëse prej këtij të fundit do të vërehet se përshkrimet nuk do të jenë të hartuara në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard duhet t’i kthejë për rishikim.

15. Të kërkoj nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar të plotësohen dosjet e personelit, duke filluar me plotësimin e të gjitha të dhënave të Fletës-Prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit dhe gjithë dokumentacionin e kërkuar nga VKM nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”, e posaçërisht nga Lidhja 1 që shoqëron këtë vendim.

16. Detyrat e përmendura në pjesën urdhëruese të këtij vendimi duhet të përmbushen brenda një afati prej **30 ditësh** nga marrja dijani e këtij vendimi.

Pas dhënies së vendimit të mësipërm, në muajin korrik të vitit 2015, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me shkresën 1057, datë 14.07.2015, “Kërkesë për anulim aktesh”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, i ka kërkuar këtij të fundit, anulimin e akteve nr.1035/3, 1035/4, 1035/5, 1035/7. 1035/11 Prot., datë 07.07.2015, për revokimin e statusit të punësimit për punonjësit ***** dhe ***** dhe akteve nr.1035/1, 1035/2 dhe 1035/12 Prot., datë 07.07.2015, të deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve ***** dhe *****.

Bazuar në shkresën e mësipërme, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr.3475/1, datë 16.07.2015, “Mbi deklarin e statusit të punësimit të nëpunësve të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka theksuar se nëpunësit për të cilët Komisioneri ka kërkuar revokimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës (***** dhe *****) e kanë filluar marrëdhënien juridike të punës me institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, përpara fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe, bazuar në këtë arsyetim, i ka kërkuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil që të marrë në konsideratë statusin që kanë këta nëpunës në shërbimin civil.

Pas rishqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e inspektimit të përgjithshëm, në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe vlerësimit të shkresave nr.3475/1, dt.16.07.2015, të Departamentit të Administratës Publike dhe nr.1057 Prot., dt.14.07.2015, të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me Vendimin nr.83, datë 31.07.2015, “Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, datë 12.03.2015”, ka vendosur:

1. Të revokoj pikat 8, 9 dhe 10 të Vendimit Nr. 23, datë 12.03.2015.
2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të lërë në fuqi aktet e deklarimit të statusit të nëpunësit civil nr. 1191/60 Prot., datë 14.08.2014, nr. 1191/65 Prot., datë 14.08.2014, dhe nr. 1191/1 Prot., datë 14.08.2014, respektivisht për punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** , ***** dhe ***** , duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme administrative.
3. Në rastet kur konstatohet se pozicionet që këta punonjës mbanin në momentin e nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të punësimit nuk figurojnë më si pozicione të lira, Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative me qëllim sistemimin e punonjësve të mësipërm në pozicionet e lira të punës, pranë këtij institucioni.
4. Detyrat e përmendura në pjesën urdhëruese të këtij vendimi duhet të përmbushen brenda një afati prej **30 ditësh** nga marrja dijani e këtij vendimi.

Në vijim, me kërkesat nr.532/5Prot., dt.07.08.2015, nr.532/6 Prot., dt.07.08.2015, nr.532/7 Prot., dt.14.08.2015 dhe nr.532/8., Prot, dt.14.08.2015, “Ankim Administrativ”, drejtuar Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, disa punonjës të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (***** , ***** , ***** , dhe *****) kanë kërkuar “Ndryshimin e aktit administrativ: Vendimit nr.83, datë 31.07.2015, “Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, datë 12.03.2015” , duke u vendosur edhe pjesa që bën fjalë për statusin e tyre të punësimit.

Edhe Departamenti i Administratës Publike me shkresat nr.3917/1 Prot., dt.19.08.2015 “Mbi ankimin administrativ të ushtruar nga *****” dhe nr.3918/1 Prot., dt.02.09.2015, “Mbi ankimin administrativ të ushtruar nga *****” i ka kërkuar Komisionerit, rivlerësimin e qëndrimit të mbajtur nga ky i fundit në Vendimin nr.23, dt.12.03.2015.

Pas rishqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e inspektimit të përgjithshëm, në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, vlerësimit të kërkesave të katër punonjësve të mësipërm dhe shkresave nr.3917/1 Prot., dt.19.08.2015 dhe nr.3918/1 Prot., dt.02.09.2015, të Departamentit të Administratës Publike, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me Vendimin nr.90, datë 10.09.2015, “Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, datë 12.03.2015” , ka vendosur:

1. Të revokoj pikat 4 dhe 6 të Vendimit Nr. 23, datë 12.03.2015.
2. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike, që në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil, të lërë në fuqi aktet e deklarimit të statusit të nëpunësit civil Nr. 1191/59 Prot., datë 14.08.2014 dhe Nr. 1191/86 Prot., datë 14.08.2014, respektivisht për punonjësit e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ***** dhe ***** , duke kryer të gjitha veprimet e nevojshme administrative.
3. Në rastet kur konstatohet se pozicionet që këta punonjës mbanin në momentin e nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të punësimit nuk figurojnë më si pozicione të lira, Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me Shërbimin Gjeologjik

Shqiptar, të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme administrative me qëllim sistemin e punonjësve të mësipërm në pozicionet e lira të punës, pranë këtij institucioni.

4. *Të mos pranojë kërkesat e punonjësve ***** dhe *****.*
5. *Detyrat e përmendura në pjesën urdhëruese të këtij vendimi duhet të përmbushen brenda një afati prej **30 ditësh** nga marrja dijeni e këtij vendimi.*

Me kalimin e afatit procedural, prej 30 ditësh Komisioneri vendosi kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim, për të verifikuar ecurinë e zbatimit të Vendimit nr.23, datë 12.03.2015, Vendimit 83, dt.31.07.2015 dhe Vendimit nr.90, dt. 10.09.2015, procedurë e bazuar në nenin 14, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i cili ishte në fuqi në kohën e kryerjes së verifikimit) dhe në Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit.

Me Vendimin nr.35, datë 01.04.2016, të Komisionerit, u ngrit grupi i punës, i cili u paraqit në subjektin e inspektuar në datën **06.04.2016** dhe i kërkoi personit përgjegjës për menaxhimin e burimeve njerëzore, nëpunëses *****, dosjet e personelit, si dhe çdo akt tjetër administrativ, të nevojshëm për të verifikuar zbatimin e vendimit.

Në përfundim të procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, rezultoi se :

- ✓ Në lidhje me rivlerësimin e praktikës së deklaramit të statusit të punësimit për nëpunësin ***** , përcaktuar në pikën 1 të pjesës urdhëruese të vendimit nr.23, datë 12.03.2015, të Komisionerit, rezultoi se Departamenti i Administratës Publike ka revokuar aktin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civil në periudhë prove nr.1191/101, datë 14.08.2014, për këtë punonjës në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Arkivit Qendror” dhe ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civil nr. 1035/2, datë.07.07.2015, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Hapësirës Bregdetare” në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Me aktin nr.1582, datë 10.11.2015, pozicioni “Përgjegjës i Sektorit të Arkivit Qendror Teknik të Gjeologjisë” është shpallur pozicioni i lirë, për t’u plotësuar përmes procedurës së konkurrimit në përputhje me ligjin.

- ✓ Në zbatim të pikës 2 të vendimit, njësia përgjegjëse, në përputhje me nenin 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurës Administrative të RSH” (i cili ishte në fuqi në atë kohë), me aktin nr. 1035/9, datë 07.07.2015, ka bërë korrigjimin e aktit të deklaramit të statusit të punësimit për punonjësin ***** , duke shënuar në të pozicionin që punonjësi mban aktualisht: “Specialist, në Sektorin e Monitorimit të Lejeve të Kërkim-Zbulimit, në Drejtorinë e Burimeve Minerare”.
- ✓ Në kuadër të rregullimit të gjendjes së ligjshmërisë në shërbimin civil në rastin e punonjësës ***** , në zbatim të pikës 3 të vendimit, rezultoi se Departamenti i Administratës Publike me aktin nr.1035/3, datë 07.07.2015, ka revokuar aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.1191/85, datë 14.08.2014, për këtë punonjëse në pozicionin “Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit” dhe me aktin nr. 1046 prot., datë 13.07.2015, “Njoftim mbi revokimin e statusit nëpunës civil dhe marrëdhëniet e punës me institucionin tonë”, njësia e burimeve njerëzore të

Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ka njoftuar përfundimin e marrëdhënies së punësimit për të.

Me aktin nr.1582, datë 10.11.2015, pozicioni “*Specialiste në Sektorin e Dixhitalizimit, në Drejtorinë e Gjeoinformatizimit*” është shpallur pozicion i lirë, për t’u plotësuar përmes procedurës së konkurrimit në përputhje me ligjin.

- ✓ Në rastin e punonjësit ***** (pika 4 e vendimit), sikundër është parashtruar edhe më sipër, Komisioneri pas kërkesës së këtij punonjësi për ndryshim të vendimit të Komisionerit, në pjesën që bën fjalë për statusin e tij të punësimit dhe shkresës së Departamentit të Administratës Publike për rivlerësim të qëndrimit të Komisionerit në këtë rast, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e inspektimit, me Vendimin Nr. 90, datë 10.09.2015, “*Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 23, datë 12.03.2015*”, ka vendosur revokimin e pikës 4 të Vendimit Nr. 23, datë 12.03.2015, duke kërkuar nga DAP lënien në fuqi të aktit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil nr. 1191/86, datë 14.08.2014.
- ✓ Në zbatim të pikës 5 të vendimit, rezultoi se Departamenti i Administratës Publike me aktin nr.1035/5, datë 07.07.2015, ka revokuar aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.1191/48, datë 14.08.2014, për punonjësën ***** në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Hartografimit në Drejtorinë e Gjeologjisë*” dhe me aktin nr. 1043 prot., datë 13.07.2015, “*Njoftim mbi revokimin e statusit nëpunës civil dhe marrëdhëniet e punës me institucionin tonë*”, njësia e burimeve njerëzore të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ka njoftuar përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës.
- ✓ Në rastin e punonjësit ***** (pika 6 e vendimit), sikundër është parashtruar edhe më sipër, Komisioneri pas kërkesës së këtij punonjësi për ndryshim të vendimit të Komisionerit, në pjesën që bën fjalë për statusin e tij të punësimit dhe shkresës së Departamentit të Administratës Publike për rivlerësim të qëndrimit të Komisionerit në këtë rast, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e inspektimit, me Vendimin Nr. 90, datë 10.09.2015, “*Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 23, datë 12.03.2015*”, ka vendosur revokimin e pikës 6 të Vendimit Nr. 23, datë 12.03.2015, duke kërkuar nga DAP lënien në fuqi të aktit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil nr. 1191/59, datë 14.08.2014.
- ✓ Në lidhje me detyrën e lënë Departamentit të Administratës Publike në pikën 7 të Vendimit Nr.23, datë 12.03.2015, të Komisionerit, për revokimin e shkresës nr. 1353/3 prot., datë 30.06.2014, “*Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar*”, për kalimin e punonjësit ***** në një pozicion të një niveli më të lartë nëpunësie, pa respektuar kërkesat e përcaktuara nga ligji, rezultoi se deri në momentin e mbarimit të verifikimit të zbatimit të vendimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk kishte asnjë reagim.

Me aktin nr. 4422, datë 17.09.2015, “*Emërim*”, të Departamentit të Administratës Publike, ***** është emëruar nëpunës civil në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Politikave të Burimeve Ujore*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Bujqësore, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. Në vijim, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, me aktin nr. 1319, datë 17.09.2015, ka deklaruar

përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare”.

Me aktin nr.1433, datë 08.10.2015, pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Gjeologjisë Detare” është shpallur pozicion i lirë, për t’u plotësuar përmes procedurës së konkurrimit në përputhje me ligjin.

✓ Në rastin e punonjësve:

1. *****, me detyrë “Specialiste në Sektorin e Gjeofizikës”;
2. *****, me detyrë “Specialist në Sektorin e Laboratorit të vetive fiziko-mekanike”;
3. *****, me detyrë “Specialist në Sektorin e Analizave të Ujërave”,

sikundër është parashtruar edhe më sipër, Komisioneri pas kërkesës së këtyre punonjësve për ndryshim të vendimit të Komisionerit, në pjesën që bën fjalë për statusin e tyre të punësimit dhe shkresës së Departamentit të Administratës Publike për rivlerësim të qëndrimit të Komisionerit në këto raste, pas rishqyrtimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e inspektimit, me Vendimin Nr. 83, datë 31.07.2015, “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 23, datë 12.03.2015”, ka vendosur revokimin e pikës 8, 9 dhe 10, të Vendimit Nr. 23, datë 12.03.2015, duke kërkuar nga DAP lënien në fuqi të akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil nr. 1191/60, datë 14.08.2014, nr. 1191/65, datë 14.08.2014 dhe nr. 1191/114, datë 14.08.2014.

- ✓ Në zbatim të pikës 11 të vendimit, njësia përgjegjëse, në përputhje me nenin 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurës Administrative të RSH” (i cili ishte në fuqi në atë kohë), me aktin nr. 1035/6, datë 07.07.2015, ka bërë korrigjimin e aktit të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin *****, duke shënuar në të pozicionin që punonjësi mban aktualisht: “Përgjegjës në Sektorin e Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë.
- ✓ Në lidhje me detyrën e lënë Departamentit të Administratës Publike në pikën 12 të vendimit nr.23, datë 12.03.2015, të Komisionerit, për revokimin e shkresës nr. 1353/3 prot., datë 30.06.2014, “Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, për kalimin e punonjësit ***** në një pozicion të një niveli më të lartë nëpunësie, pa respektuar kërkesat e përcaktuara nga ligji, rezultoi se deri në momentin e mbarimit të verifikimit të zbatimit të vendimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk kishte asnjë reagim.
- ✓ Në zbatim të pikës 13 të vendimit, pas komunikimit me njësinë e burimeve njerëzore të institucionit, rezultoi se Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, ka bërë rivlerësimin e procesit të deklarimit apo mosdeklarimit të statusit të punësimit, dhe në vijim i ka dërguar Departamentit të Administratës Publike, shkresat nr. 621 prot., datë 10.04.2015 dhe nr.179 prot., datë 31.01.2017, me anë të të cilave ka kërkuar nga ky i fundit rishikimin edhe një herë të këtyre akteve.
- ✓ Sa i takon rekomandimit për hartimin e përshkrimeve të punës, sanksionuar në pikën 14 të vendimit, rezultoi se formati i përshkrimit të punës është bërë sipas lidhjes 4, bashkëlidhur Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës

shtetërore dhe institucionet e pavarura". Përshkrimet e punës janë nënshkruar nga nëpunësi civil, eprori direkt, si dhe nga Drejtori i Përgjithshëm.

- ✓ Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 15, rezultoi se me shkresën nr.268, datë 17.02.2015, Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për të gjithë punonjësit. Në zbatim të këtij rekomandimi, ishin plotësuar të dhënat e Fletës-Prezantuese të dosjes teknike të nëpunësve sipas kërkesave të VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014, "*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*".

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimit nr.23, datë 12.03.2015, Vendimit 83, dt.31.07.2015 dhe Vendimit nr.90, dt. 10.09.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*" dhe 34 të Rregullores, "*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*", miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr.23, datë 12.03.2015, Vendimit 83, dt.31.07.2015 dhe Vendimit nr.90, dt. 10.09.2015 në institucionin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 23, datë 23.03.2015 "*Për miratimin e raportit përfundimtar të inspektimit të përgjithshëm në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Shërbimi Gjeologjik Shqiptar*", Vendimit nr. 83, datë 31.07.2015 "*Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, dt.12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*" dhe Vendimit nr.90, datë 10.09.2015 "*Për disa ndryshime në Vendimin nr.23, datë 12.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil*".
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA